



ODA E NOTERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
Notarska Komora Republike Kosova/Notary Chamber of the Republic of Kosovo
Këshilli Drejtues i Odës

Nr. 34-2/2019
Më: 29.11.2019

Në pajtim me Nenin 63, paragrafi 2.4, Nenin 66, paragrafi 1 dhe 3, Nenin 67, paragrafi 2 i Ligjit për Noterinë Nr. 06/L-010, Nenin 9, paragrafi 4.12, Nenin 19, Paragrafi 2, paragrafi 3. 25, Neni 43, paragrafi 1.2 të Statutit të Odës së Noterëve, si dhe me aprovimin paraprak të Kuvendit të Odës bazuar në Vendimin e Kuvendit të Odës së Noterëve, Nr.32/2019 datës 02.11.2019, Këshilli Drejtues i Odës, merr këtë:

V E N D I M

1. **LEJOHET** blerja e parcelave me Nr. P-71914075-00410-3, në sipërfaqe prej 378m² dhe P-71914075-00410-4, në sipërfaqe prej 390 m², në total 768m², ZK Çagllavicë-ZKK Prishtinë, me pronar Agron Nazmi Berisha, në shumën prej 20.000 € (Njëzet mijë euro) për 1 ARI, e në shumën totale prej 153.600 € (Njëqind e pesëdhjetë e tremijë e gjashtëqind Euro).
2. **AUTORIZOHET** znj. Sevdije Krasniqi, si Kryesuese e Komisionit për identifikimin e lokacionit dhe parcelës së përshtatshme për blerje që ta përfaqësoj Odën e Noterëve të Republikës së Kosovës dhe nënshkruaj kontratën e shitblerjes për parcelat e precizuara në pikën 1 të këtij vendimi në emër të Odës së Noterëve në cilësinë e blerësit.

3. Shuma prej 153.600 € (Njëqind e pesëdhjetë e tremijë e gjashtëqind Euro) për blerjen e parcelave nga pika 1 e këtij vendimi do të mbulohen/paguhet nga llogaria bankare e Odës së Noterëve.
4. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit

A r s y e t i m

Oda e Noterëve të Republikës së Kosovës, me Vendimin e vet Nr.32/2019 datë 02.11.2019, në Kuvendin e mbajtur të Odës, si pikë të vetme diskutimi kishte *Njoftimin dhe vendosjen rreth parcelës së përzgjedhur për ndërtimin e selisë së Odës së Noterëve*, bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues të Odës dhe atë të Vendimit të mëhershëm të Kuvendit të Odës për identifikimin e lokacionit dhe parcelës të përshtatshme për ndërtimin e Selisë së Odës së Noterëve.

Pas prezantimit të situatës rreth identifikimit të lokacionit dhe parcelës së përshtatshme për blerje gjatë këtij Kuvendi e bëri znj. Sevdije Krasniqi, e cila bazuar në Vendimin nr 10-2/2019, të datës 22.02.2019 ishte caktuar nga Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve si Kryesuese e Komisionit për identifikimin e lokacionit dhe parcelës së përshtatshme për ndërtimin e një selie të përhershme të Odës së Noterëve. Znj. Krasniqi në këtë kuvend paraqiti se nga disa lokacione të shikuara në disa vende, më të përshtatshme për ndërtim dhe në çmim janë vetëm dy parcela të cilat në total kanë një sipërfaqe prej 768m² edhe atë parcelat me Nr. P-71914075-00410-3, në sipërfaqe prej 378m² dhe P-71914075-00410-4, në sipërfaqe prej 390 m², të cilat gjenden në Prishtinë, Zona Kadastrale dhe vendi i quajtur Çagllavicë, me pronar Agron Nazmi Berisha, në shumën prej 20.000 € (Njëzet mijë euro) për 1 ARI, e në shumën totale prej 153.600 €.

Pas prezantimit të të njëjtave, Kuvendi i Odës vendosi që këtë propozim, me 45 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim ta APROVOJ dhe lejoi blerjen e këtyre parcelave. Por, me rekomandim që të shikohet mundësia edhe për ndonjë ofertë tjetër të re eventuale, ashtu që, Këshillit Drejtues iu rekomandua që ta bëjë edhe një shpallje publike në dy gazeta, e cila duhet të jetë e hapur për ofertim nga të gjitha palët e interesuara për 14 ditë radhazi, ashtu që të kemi edhe oferta të tjera eventuale.

Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve me Vendimin nr. 32/2019, të datës 02.11.2019, shpalli ftesën publike për blerje të parcelës në emër të Odës së Noterëve, e cila udhëhiqet nga vetë Këshilli Drejtues. Me datë 06.11.2019, ftesa Publike u publikua në gazetën ditore "BOTA SOT", faqe 30 e gazetës, dhe në gazetën ditore "EPOKA E RE", faqe me nr. 23, si dhe e njëjta u publikua edhe në ueb faqen zyrtare të Odës së Noterëve. Përkundër se shpallja publike ishte e hapur për 14 ditë rresht, me përjashtim të ofertuesit z. Agron Berisha, nuk pati ofertues të tjerë, andaj bazuar edhe në Vendimin e Kuvendit të Odës të datës 02.11.2019, për blerjen e këtyre parcelave, Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve vendosi si më lartë.

Aliriza Beshi

Kryetar i Odës së Noterëve

